

PRIVATIZIMI DHE EFIKASITETI I TIJ
NË SHQIPËRI

Vasi Pano
Drejtor Drejtorie
Ministria Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

ASPEKTE MAKROEKONOMIKE NË FILLIM TË VITEVE '90

Procesi i reformës ekonomike filloi në korrik të vitit 1992, kur programi i qeverisë u mbështet nga marrëveshja "Stand By" me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Objektivat kryesorë ishin:

1. Stabiliteti makroekonomik, i cili synonte reduktimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit dhe liberalizimin e çmimeve.
2. Ristrukturimi i sektorit shtetëror nëpërmjet eliminimit të subvencioneve prej shtetit, nxitja dhe zhvillimi i konkurrencës së lirë dhe riorganizimi i sektorit publik, përfshirë sistemin bankar.
3. Privatizimi i ekonomisë, që u konceptua si një transferim i të drejtave nga sektori shtetëror në sektorin joshtetëror, duke synuar rritjen e standardit të jetesës nëpërmjet eliminimit të joefikasitetit të shtetit.

Në fillim të viteve '90, njësitë ekonomike që vepronin në të gjithë sektorët e ekonomisë ishin në gjendje mjaft të vështirë:

- me teknologji të prapambetur dhe me gjendje teknike të ulët, si pasojë e mungesës së investimeve të reja në këta sektorë për një periudhë mjaft të gjatë kohore;
- me fuqi të tepërt punëtore;
- të bllokuar në treg dhe me gjendje të lartë debitore;
- me nivel të ulët administrimi, planizim inadkuat aktual dhe perspektiv, ndërhyrje të theksuar të shtetit në veprimet e përditshme, njohje të cekët të ligjeve dhe të rregullave të tregut;
- me mungesë kapaciteti për të administruar situatat e krizës dhe pamundësi për të falimentuar;
- me nivel të ulët të disiplinës financiare, sisteme inadkuate të matjes dhe kontrollit;
- me objektiva të paqartë, të shumëfishtë (pa kahje) dhe konfliktuale;
- nën patronazhe politike që nuk lejonin një veprimtari eficiente të njësive ekonomike.

Gjendja e rëndë në këta sektorë kërkonte ndërhyrje cilësore rishtrukturoese, liberalizuese dhe derregulluese, të shoqëruar më pas me atë privatizuese. Ndërhyrjet për rikapitalizim kërkonin investime në vlera të mëdha të papërbalueshme, të cilat kërkonin tërheqjen e kapitaleve të huaja apo vendase private për të riaktivizuar dhe përdorur me efektivitet burimet natyrore dhe njerëzore të këtyre sektorëve.

Industria pati pësuar rënie për shkak të vështirësive të mëdha që hasnin fabrikat dhe uzinat në përballimin e konkurrencës me mallrat e importit si rezultat i teknologjisë së tyre të vjetëruar. Ndërmjet faktorëve të tjerë, kostot e larta të lëndëve të para të importuara, joefikasiteti në drejtimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe rregullat e reja të tregut, bënë që produkti i prodhuar në vend të ishte më i shtrenjtë se produkti i importuar. Megjithë koston e ulët të fuqisë punëtore në krahasim me vendet e tjera, shumica e ndërmarrjeve shtetërore dështuan. Por, nga ana tjetër, gjatë privatizimit, rënia e prodhimit industrial u ngadalësua dhe duke filluar që nga viti 1993 e në vazhdim, ky prodhim ka qenë pothuajse konstant megjithëse në një nivel shumë të ulët (31 për qind në vitin 1997 krahasuar me nivelin në vitin 1990).

PROCESI I PRIVATIZIMIT NË SHQIPËRI

Në procesin e transformimit ekonomik, që po pëson vendi ynë, privatizimi është konceptuar jo vetëm si ndryshim pronësie, por si një alternativë e re që do të sigurojë funksionimin efektiv të veprimeve të " lojtarëve të tregut ", privatë apo shtetërorë, dhe të garantojë konkurrencë leale midis tyre. Ky proces shoqërohet me një kompleks problemesh, ndryshimesh dhe interesash politikë, socialë, makro dhe mikroekonomikë dhe ligjorë.

Synimi përfundimtar i qeverisë, nëpërmjet procesit të privatizimit, është realizimi i transferimit të të drejtave shtetërore tek privatët në të gjitha format e saj dhe nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dhe eficient. Në këtë kontekst, privatizimi është përkufizuar si transferimi i tre lloje të drejtash nga shteti tek sektori privat:

- të drejtës së pronësisë;
- të drejtës së përdorimit;
- të drejtës së zhvillimit;

Nëpërmjet transferimit të të drejtës së pronësisë (shitjes), shteti çlirohet nga të gjitha llojet e rrezikut që lidhen me administrimin e ndërmarrjes apo të shoqërisë, ndërsa nëpërmjet transferimit të të drejtës së përdorimit (kontratat e administrimit, shërbimit etj.) shteti, përgjithësisht, mbetet i përfshirë në monitorimin e kushteve kontratore dhe të rrezikut financiar nëse njësi ekonomike del me humbje.

Kontratrat e koncensionit, të skemave BOT; BOOT; ROT dhe dhënia me qira apo enfiteozë janë ndër mënyrat e përdorura gjatë privatizimit për transferimin njëkohësisht të të drejtës së përdorimit dhe asaj të zhvillimit, të cilat përfshijnë ose jo shtetin në rrezikun financiar, në varësi të kontratave specifike.

Në Shqipëri transferimi i të drejtës së pronësisë është përdorur gjerësisht në procesin e privatizimit gjatë periudhës 1991-2000.

OBJEKTIVAT E PRIVATIZIMIT

Privatizimi nuk është një qëllim në vetvete. Do të ishte shumë sipërfaqësor konsiderimi i privatizimit si një zbutës i vështirësive të shumta që pati hasur sektori publik në ekonomi apo si një ndryshim thjesht i pronësisë, apo i futjes së administrimit privat. Kjo platformë nuk do t'i shtronte rrugën efikasitetit financiar dhe ekonomik. Në vende të ndryshme janë bërë përpjekje të mëdha

për përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe rritjen e rezultateve të ecurisë të njësive ekonomike shtetërore, si rrjedhim privatizimi përbën vetëm një nga elementet e procesit të reformimit të ekonomisë dhe të të gjithë shoqërisë.

Strategjia e privatizimit ka synur në objektivat kryesorë të mëposhtëm:

- Përgatitje e shpejtë e procesit dhe tek të gjithë sektorët.
- Rigjallërim i ekonomisë nëpërmjet përdorimit eficient të burimeve njerëzore dhe natyrore.
- Garantim i ritmeve të qëndrueshme në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë.
- Mbështetje dhe fuqizim i sektorit privat në aktivitetin e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve.
- Tërheqje e investitorëve potencialë dhe strategjikë.
- Krijim i kushteve për krijimin e tregut të kapitaleve.

Privatizimi në Shqipëri nuk është konturuar dhe realizuar si një transferim standard i të drejtave të pronësisë ndërmjet dy (ose më shumë) agentëve ekonomikë të përcaktuar mirë, por edhe me krijimin e strukturave të të drejtave të pronësisë, që nuk kanë ekzistuar më parë. Ndërsa në vendet perëndimore, privatizimi mund të shikohet si një proces reformimi, në vendet lindore sikurse dhe në vendin tonë, privatizimi është një proces thelbësor i një transformimi sistemik të shoqërisë në tërësi.

Duke e konsideruar fazën zbatuese të procesit të privatizimit, si domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik, programi në kontekstin e objektivave kryesorë, ka synuar të jetë:

- i shtrirë në të gjithë sektorët e ekonomisë;
- në mënyrë efektive i shpejtë, i drejtë nga pikëpamja shoqërore dhe transparent;
- promotor i rigjallërimit të ekonomisë, nëpërmjet rritjes së eficiencës ekonomike dhe aftësisë konkurruese të sektorëve, përdorimit efektiv të burimeve njerëzore, natyrore dhe pozicionit gjeopolitik;
- ristrukturues dhe mbështetës pas privatizimit për të garantuar ritme të qëndrueshme rritjeje, zhvillimin dhe fuqizimin e pronës, bazë e domosdoshme për zhvillimin konkurrencial të të gjitha tregjeve, rritje të balancuar ekonomike;
- proces mbështetës dhe fuqizues i aktiviteteve prodhuese vendase dhe të investitorëve të huaj;

si dhe të arrijë përfitimet dhe të garantojë qëllimet si më poshtë:

- demokratizimin e pronësisë;
- paqen sociale, ngritjen e nivelit të jetesës;
- reduktimin e deficitit buxhetor, rritje e të ardhurave direkte dhe indirekte buxhetore;
- promovimin e rritjes së eficiencës ekonomike, nëpërmjet pjesëmarrjes së sipërmarrjeve private dhe, për rrjedhojë, kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve dhe të qytetarëve;
- reduktimin e borxhit publik dhe të jashtëm;
- zhvillimin e tregut kombëtar të kapitaleve;
- forcimin e konkurrencës dhe dobësimin e monopoleve;
- reduktimin e interferencës (prezencës) së shtetit në ekonomi;
- konfrontimin e njësive ekonomike me disiplinat dhe me rregullat e tregut;
- rritjen e cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve;
- rritjen e afatgjatë të numurit të vendeve punës dhe rritjen e alternativave të punësimit nëpërmjet alokimit të burimeve njerëzore në treg të lirë;
- krijimin dhe fortifikimin e klasës së administratorëve nëpërmjet investimeve në teknologji dhe në aftësitë menaxheriale, të cilët do të jenë një bazament me shumë vlerë për demokracinë dhe për stabilitetin politik.

Përfitimet e mësipërme kryesisht synojnë, në rradhë të parë, rigjallërimin ekonomik të vetë sektorëve. Por, krijimi i një tregu konkurrencial për prodhimet dhe shërbimet në sektorët me rëndësi të veçantë të ekonomisë, në mënyrë direkte do të japë efektet e tij në lulëzimin edhe në sektorët ndihmës të shërbimeve, prodhimit të vogël artizanal dhe agroindustrial. Ky efekt do të jetë i menjëhershëm në uljen e çmimeve të produkteve për treg, në rritjen e efektivitetit të biznesit privat, në rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve publike ndaj konsumatorëve dhe popullatës, në nxitjen e iniciativave të reja dhe në hapjen e vendeve të reja të punës.

OBJEKTET E PRIVATIZIMIT

Shqipëria ka qenë një nga ekonomitë më të shtetëzuara, ku pothuajse e gjithë prona private ishte e çrrënjësuar. Për këtë arsye, privatizimi nuk është konsideruar thjesht si një transferim të drejtash, por kryesisht si një mënyrë e rikthimit për njerëzit, e të drejtave të mohuara për një gjysmë shekulli.

Ky proces privatizimi ka përfshirë çdo gjë që shteti e konsideronte si pronë të tij, domethënë, tokën, shtëpitë, ndërmarrjet dhe shoqëritë.

Toka bujqësore, trojet, pyjet

Toka bujqësore, trojet dhe pyjet kanë qenë objekt i shpërndarjes tek fshatarët ose i rikthimit tek ish-pronarët, bazuar në ligjet e Kuvendit dhe në vendimet e ndryshme të Këshillit të Ministrave. Fillimisht, shitja e tokës bujqësore, e trojeve apo e pyjeve ishte e ndaluar. Por, kjo është bërë e mundur, me disa kufizime, që prej korrikut të vitit 1995.

Shtëpitë e banimit

Të gjitha shtëpitë e banimit shtetërore, pallate/ apartamente, ju shitën njerëzve që jetonin në to, në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj.

Ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore

Të gjitha ndërmarrjet shtetërore janë objekt i procesit të privatizimit. Ato janë ndarë në ndërmarrje të sektorit strategjik (me rëndësi të veçantë ekonomike) dhe të sektorit jostrategjik, dhe mënyrat për privatizimin e tyre kanë patur specifikën e tyre.

Spektori financiar

Spektori financiar përfshin sektorin bankar, institutet e sigurimit dhe institutet e pensioneve. Deri tani janë ndërmarrë hapa vetëm në drejtim të privatizimit të sektorit bankar, pothuajse tërësisht në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe janë arritur disa rezultate. Privatizimi i tyre realizohet me ligj të veçantë nga Ministria e Financave.

Shërbimet sociale

Shërbimet sociale që mund të ofrohen nga sektori privat janë të ndryshme, duke filluar nga grumbullim plehërash, pastrim dhe riparim rrugësh, mbrojtje nga zjarri, shërbimet shëndetësore, e deri tek arsimi dhe kualifikimi, trajtimi i ujërave të zeza, vaditja, mirëmbajtja e muzeumeve, inspektimi i sigurimit teknik dhe transporti urban. Në Shqipëri, në kontekstin e përkufizimit të privatizimit, të gjitha këto shërbime kanë qenë objekt privatizimi.

KUADRI LIGJOR I PRIVATIZIMIT NË SHQIPËRI

Procesit të privatizimit ju hap "drita jeshile" nga Kuvendi në vitin 1991, me ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" dhe më pas u pasurua me ligjin nr.8306, datë 14.3.1998, "Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë".

Tre kanë qenë parimet më kryesore të kuadrit ligjor:

- prona private;
- iniciativa e lirë;
- procesi i privatizimit.

Në start të kësaj periudhe kritike të tranzicionit (1991), privatizimi u mendua të ishte një mënyrë për çlirimin prej pronës shtetërore dhe prej administrimit të ndërmarrjeve publike, sa më shpejt dhe sa më tërësisht që të ishte e mundur. Kështu që, nuk u përpunua si dokument ndonjë strategji për procesin e privatizimit. Kryesisht për realizimin e procesit të privatizimit u miratuan akte nënligjore në nivelin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat u përdorën sidomos gjatë viteve 1993-1996 për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Objektivi kryesor strategjik i privatizimit ishte nxitja e rritjes, së pari të pronësisë private dhe së dyti, të pronësisë në grup, duke theksuar që, shteti në këtë proces dëshiron të transferojë të drejtat e tij. Në këtë kontekst, çdo pjesë e pronës publike në Shqipëri do t'i nënshtrohet privatizimit.

Karakteristikat kryesore të këtij procesi u vendos të ishin:

Shpejtësia

"Shpejtësia" duhet të jetë një karakteristikë esenciale për të gjithë procesin e privatizimit. Çdo ent shtetëror i përfshirë në procesin e privatizimit duhet të reduktojë, në minimumin e mundshëm, kohën që i duhet për të përmbushur detyrat e tij.

Drejtësia sociale

Shteti siguron procedurat e nevojshme me qëllim që të mbikëqyrë drejtësinë sociale gjatë procesit të privatizimit. Kjo, nga njëra anë nënkupton mbështetje për ish-pronarët, ish të përndjekurit politikë, punonjësit e ndërmarrjeve në privatizim, intelektualë dhe drejtues të shquar dhe, nga ana tjetër, synon parandalimin e rënies së

pasurisë shtetërore në duart e të korruptuarve, të të privilegjuarve ose të ish-funksionarëve komunistë etj..

Transparenca

Pas përgatitjes së dokumenteve për privatizim nga ana e institucioneve respektive, ndërmarrjet shtetërore (NSH) ose pjesë të tyre që do të privatizohen, do të publikohen në gazeta dhe media të tjera. Procedurat e mëtejshme ndjekin ligjet, dekretet, vendimet dhe udhëzimet e qeverisë. Procesi, procedurat dhe rezultatet duhet të jenë transparente për këdo, për të shmangur korrupsionin.

RIKTHIMI DHE KOMPENSIMI

Rikthimi është procesi i dhënies së pronave të konfiskuara nga shteti ish-pronarëve, ndërsa kompensimi është dhënia e vlerës së pronës që zotëronin ish-pronarët. Ky proces është shumë i rëndësishëm në procesin e privatizimit dhe gjerësia në të cilën ato përdoren pa dyshim që ndikon në shpejtësinë dhe efikasitetin e vetë procesit të privatizimit.

Në Shqipëri, për arsye specifike historie, sociale dhe politike, rikthimi u bë një nga mënyrat më të pranueshme të dhënies së pronave të trashëguara ish-pronarëve të tyre, pavarësisht nga vështirësitë dhe parregullsitë që kanë shoqëruar këtë proces pas.

METODAT E PRIVATIZIMIT

Në zgjedhjen e metodës së privatizimit ndikojnë faktorë të ndryshëm, përfshirë këtu madhësinë e ndërmarrjes që do të privatizohet, sikurse dhe karakteristikat e blerësve / investitorëve të mundshëm.

Në Shqipëri, ligji lejon përdorimin e të gjitha llojeve të metodave të privatizimit. Të gjitha këto metoda, bazuar në objektet që do të privatizohen.

Metodat e privatizimit në Shqipëri mund të ndahen në dy grupe:

Metodat "zhveshëse" nga pronësia

Duke zbatuar metoda "zhveshëse" shteti i transferon të drejtat e pronësisë pronarit të ri privat, pa mbajtur ndonjë rrezik financiar. Megjithatë, papunësia e gjeneruar nga privatizimi është një rrezik social, që shteti duhet ta marrë në konsideratë dhe duhet ta

përballojë. Kështu, një përfshirje indirekte financiare e shtetit është e pashmangshme.

Metodat e përmendura më poshtë karakterizohen nga mënyra e transferimit të të drejtës së pronësisë.

Shitja direkte

Me këtë metodë "zhveshëse" shteti i shet drejtpërdrejt një ndërmarrje (ose pjesë të saj) blerësve privatë. Shitja direkte mund të kryhet në dy mënyra:

- shitje direkte nëpërmjet ankandit/tenderit;
- shitje tek një blerës i paracaktuar.

Mënyra e dytë është më e përdorur në Shqipëri. Objekte të privatizuara me këtë metodë ishin kryesisht shtëpitë e banimit, dyqanet, restorantet, pjesë të ndërmarrjeve etj. (i ashtuquajturit privatizimi i vogël).

Shitja drejtuesve dhe punonjësve (MBO, EBO)

E përbashkëta për këto skema privatizimi është se të drejtat e pronësisë i transferohen një grupi të caktuar, që mund të jenë drejtues apo punonjës të ish-ndërmarrjes.

Në Shqipëri këto skema janë përdorur kryesisht për të privatizuar pjesë (nënjësi) ndërmarrjesh.

Ankandi publik

Me këtë metodë që është përdorur për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (ose pjesë të tyre) pronësia transferohet nëpërmjet një konkurimi të hapur. Arsyet për përdorimin e kësaj metode ishin:

- për t'i bërë sa më transparente teknikat e privatizimit;
- politikisht është një metodë më e pranueshme se privatizimi me metodat e tjera, si për shembull, shitja direkte;
- maksimizimi i rezultateve të privatizimit.

Në fakt, kjo metodë nuk ka dhënë rezultatet e pritshme.

Likuidimi

Likuidimi është mbyllja e një kompanie dhe shitja e aktiveve të saj, përdërisa ajo e ka ndërprerë veprimtarinë e saj, shpesh për shkak të falimentimit.

Në "teorinë" e privatizimit thuhet që kjo metodë privatizimi përdoret në disa rrethana të caktuara. Për arsye të ndryshme, qeveria mund të preferojë të likujë një ndërmarrje dhe të shesë aktivet e saj, në vend që ta shesë atë si ndërmarrje në funksionim.

Në Shqipëri, pas liberalizimit të çmimeve në vitin 1991, shumë ndërmarrje shtetërore falimentuan. Likuidimi do të kishte qenë metoda më e mirë për privatizimin e tyre. Sidoqoftë, termi privatizim u preferua në vend të termit likuidim. Metodat e sipërpërmendura (shitja direkte, MBO, EBO, ankandi publik) shpesh janë parandjekur nga ky falimentim "i padeklaruar".

Privatizimi masiv

Metoda e privatizimit masiv (MPM) bazohet në shpërndarjen pa pagesë të letrave me vlerë për popullsinë. Kjo metodë synon privatizimin e shpejtë të ndërmarrjeve, të transformuara paraprakisht në shoqëri tregtare, nga një numër i madh qytetarësh, mbajtës të letrave me vlerë.

Argumenti i MPM është fakti që pronësia mbi mjetet e prodhimit konsiderohet se i përket të gjithëve. Ky fakt, mbështetur edhe nga mungesa e mjeteve financiare nga ana e shtetasve shqiptarë për të marrë pjesë në ankandet për privatizimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, bëri që privatizimi masiv, i cili atëherë u nxit nga Banka Botërore dhe u adoptua nga qeveria, të ishte fillimisht një nga metodat më të pranuar politikisht.

MPM u pa pozitivisht vetëm nga ana e kërkesës (domethënë letrat me vlerë për njerëzit) dhe jo nga ana e ofertës (domethënë ndërmarrjet/shoqëritë që mund të privatizoheshin me MPM).

Instrumenti i përdorur për zbatimin e kësaj metode ka qenë ankandi publik.

Investitori strategjik

Kjo metodë nënkupton negocime direkte midis shtetit, si pronar i përfaqësuar nga autoriteti respektiv dhe investitorit privat që do të

marrë shumicën e aksioneve që i garantojnë drejtimin e ndërmarrjes. Investitori strategjik shihet shpesh si parakusht për të siguruar teknologji dhe mjete financiare në dispozicion të ndërmarrjes së privatizuar.

Në fillim, kjo metodë u mendua të përdorej vetëm për të ashtuquajturin sektor strategjik. Por, në fakt, pas privatizimit të shoqërive të para tregtare me MPM dolën shumë probleme, të cilat u gjykua që mund të zgjidheshin duke zbatuar metodën e investitorit strategjik për shumicën e aksioneve.

Kjo metodë është përdorur e kombinuar me MPM me formulën: paketa kontrolluese e aksioneve për investitorin strategjik dhe pjesa tjetër e aksioneve për publikun me MPM.

Instrumenti për zbatimin e kësaj metode është ankandi i hapur ose tenderi.

Metodat "jo-zhveshëse" nga pronësia

Metodat "jo-zhveshëse" mund të jenë një hap i ndërmjetëm drejt privatizimit (shitjes), duke treguar aftësinë e ndërmarrjes që do të shitet për të mbijetuar në treg. Shteti mbetet pronar dhe transferohen në sektorin privat vetëm të drejtat e përdorimit dhe/ose të drejtat e zhvillimit, ndoshta së bashku me njëfarë rreziku financiar.

Transformimi

Transformimi përfshin shndërrimin e ndërmarrjeve shtetërore në formën ligjore të një shoqërie tregtare private, përcaktuar me ligjet përkatëse.

Arsyeja e transformimit është që ndërmarrjet shtetërore duke vepruar në kushte ligjore dhe ekonomike të njëjta si shoqëritë private, do të fitojnë aftësinë për të mbijetuar dhe do të bëhen të privatizueshme. Dallimi i vetëm i tyre nga shoqëritë private është se aksionmbajtës është vetë shteti.

Në Shqipëri, transformimi konsiderohet si hap i parë drejt privatizimit veçanërisht me MPM, me metodën e investitorit strategjik apo me ofertë publike të aksioneve.

Në fillim u mendua që periodha kohore midis transformimit dhe privatizimit të ishte shumë e shkurtër, kështu që nuk ju vu theksi asministrimit. Shpejt u bë e qartë që pothuajse në të gjitha rastet,

transformimi nuk përmirësoi ecurinë e shoqërive tregtare shtetërore, pavarësisht se periudha deri në privatizim (kryesisht me MPM) ka qenë, në shumicën e rasteve, relativisht e shkurtër.

Ristrukturimi

Qëllimi i ristrukturimit është rritja e vlerës së ndërmarrjeve shtetërore me qëllim që ato të bëheshin sa më atraktive dhe të privatizueshme.

Ristrukturimi në Shqipëri është parë në aspektet organizative, financiare dhe teknike. Një përpjekje në këtë drejtim u bë me krijimin e Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve (ARN), e propozuar, ngritur, organizuar dhe mbështetur financiarisht nga Banka Botërore. Portofoli i ARN-së konsistonte në 32 ndërmarrje, por për shkak të konceptimit, që në themel të papërshtatshëm, ARN nuk pati sukses dhe u shkri në vitin 1996.

Dhënia me qira apo enfitoze

Dhënia me qira apo enfitoze është një marrëveshje kontraktuale me anë të së cilës pronari shtet i një aktivi (i cili ka humbur objektin e tregut) i jep një subjekti tjetër, të drejtën e përdorimit dhe të zhvillimit të aktivitetit dhe të përfitimit prej tij, për një periudhë të caktuar kohe, në këmbim të pagesës së një tarife.

Shoqëritë me kapital të përbashkët

Shoqëritë me kapital të përbashkët mund të përkufizohen si një partneritet ndërmjet shtetit dhe subjekteve ligjore private, që zotërojnë së bashku shoqërinë dhe ndajnë rreziqet dhe përfitimet e këtij partneriteti.

Shoqëritë me kapital të përbashkët ndahen në dy kategori:

marrëveshje kontraktore;

marrëveshje me kapital.

Në fillim kjo metodë u mendua të përdorej gjerësisht, për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe tregut të ndërmarrjeve shtetërore, por rezultoi me një dështim total në shumicën e rasteve.

Kontrata shërbimi

Sipas metodës së kontraktimit, një autoritet publik nënkontraktton një firmë private për të kryer disa shërbime specifike në emër të një enti publik.

Kjo metodë në Shqipëri filloi të zbatohet vonë dhe vetëm për disa shërbime sociale si grumbullimi i mbeturinave publike, riparimi dhe pastrimi i rrugëve.

Kontratat koncensionare

Me dhënien e një koncensionit, shteti i transferon të drejtat e përdorimit dhe/ose të zhvillimit sektorit privat.

Kjo metodë u parashikua të përdorej në zhvillimin e burimeve natyrore, utilitete, si në sektorin minierar, të infrastrukturës ujore dhe të transportit, dhe në sektorin e prodhimit të energjisë.

PRIVATIZIMI I NDËRMARRJEVE

Aspekte të përgjithshme

Vështrim i shkurtër dhe disa përkufizime.

Privatizimi i ekonomisë së centralizuar u konsiderua nga qeveria si pikë kritike dhe njëkohësisht si aks i reformës ekonomike që në fillimet e saj në vitin 1991. Duke parë aktet ligjore dhe institucionet e përfshira, sasinë e aktiveve, kohëzgjatjen, impaktin social, kompleksitetin e problemeve etj., mund të thuhet se privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore (NSH) ka qenë vazhdimisht në qendër të procesit të privatizimit. Kjo nuk do të thotë se privatizimi i tokës bujqësore dhe i shtëpive të banimit janë më pak të rëndësishëm, por shpjegon përse në Shqipëri fjala "privatizim", pothuasje gjithmonë, nënkupton privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Duke vështruar prapa, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore ka patur shumë ulje dhe ngritje, suksese dhe dështime, të cilat natyrisht janë shoqëruar me debate të shumta për alternativat e ndjekura ose jo.

Në privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore në Shqipëri janë përdorur thuajse të gjitha metodat e privatizimit. Madje edhe brenda një ndërmarrjeje të vetme janë përdorur disa metoda

privatizimi. Metodatat kanë qenë të lidhura ngushtë me madhësinë e ndërmarrjeve dhe ato janë:

1. shitja direkte apo me “rezervë” për objekte dhe ndërmarrje të vogla (i ashtuquajtur “privatizim i vogël”);
2. ankandi publik për ndërmarrje të vogla dhe të mesme;
3. privatizimi masiv dhe investitori strategjik për ndërmarrje të mesme dhe të mëdha.

Sipas të dhënave jo të plota, të përpunuara nga projekti i GTZ Gjermani në Shqipëri - “Legjislacioni ekonomik, Privatizimi dhe Ristrukturimi”, në fillim të procesit të privatizimit në vitin 1991, në Shqipëri kishte të paktën 2434 ndërmarrje shtetërore, të shpërndara në 18 sektorë të ndryshëm ekonomikë. Më shumë se gjysma e tyre (1280), sig tregohet në tabelën e mëposhtme, janë në sektorët e shërbimeve, të tregtisë, të bujqësisë dhe të përpunimit ushqimor.

Nr	Sektori ekonomik	Numër	%	Akumulativ
1	Shërbim dhe tregti	623	25.6	25.6
2	Bujqësi	365	15.0	40.6
3	Përpunim ushqimor	292	12.0	52.6
4	Ndërtim dhe material ndërtimi	247	10.1	62.7
5	Transport	142	5.8	68.6
6	Të ndryshme arsim, farmaceutikë	107	4.4	73.0
7	Dru dhe letër	98	4.0	77.0
8	Prodhim artizanal	89	3.7	80.6
9	Industri mekanike	85	3.5	84.1
10	Naftë dhe gaz	69	2.8	87.0
11	Industri minerare	66	2.7	89.7
12	Industri energjitike	64	2.6	92.3
13	Tekstile dhe veshje	60	2.5	94.8
14	Turizëm	44	1.8	96.6
15	Tipografi	29	1.2	97.8
16	Industri kimike dhe plastike	28	1.2	98.9
17	Industri metalurgjike	14	0.6	99.5
18	Industri lëkure	12	0.5	100.0

	Totali	2434	100.0	
--	--------	------	-------	--

*) Ndërmarrjet shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë përfshirë në këtë numër.

Shitja direkte dhe metoda e shitjes drejtuesve / punonjësve

Aspekte të përgjithshme.

Sipas kësaj metode "zhveshjeje" nga pronësia, ndërmarrja (ose pjesë të saj) u është shitur direkt blerësve privatë. Rreziku financiar së bashku me të drejtat e pronësisë i janë transferuar blerësit. Shitja direkte rezervë dhe shitja drejtuesve/punonjësve (M/EBO)", ishin metodat kryesore të përdorura në fillim të procesit të privatizimit.

Në vitet 1990-1991, ndërmarrjet shtetërore të sektorit të shërbimeve ishin pothuajse të falimentuara. Ndërmarrjet shtetërore nuk ishin në gjendje të siguronin cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kërkuara nga popullsia. Privatizimi i shpejtë i shërbimeve ishte e vetmja rrugë për të kapërcyer këto vështirësi.

Qeveria u përpoq të gjente cila ishte rruga më e mirë e privatizimit me synimin për të riaktivizuar shërbimet tregtare. Njohuritë profesionale (know-how) u konsideruan si kriteri kryesor për gjetjen e pronarëve të rinj më të mirë në shërbimet e tregtisë dhe të biznesit. Logjika ishte e thjeshtë: "ai që e di më mirë është në gjendje të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e shërbimeve më shpejt se kushdo tjetër".

Kështu që, drejtuesit dhe punonjësit e ndërmarrjeve shtetërore në sektorin e shërbimeve u konsideruan si blerësit më të mirë. Metodatat e privatizimit M/EBO u menduan se ishin metodatat më efektive dhe më të shpejta, por as metoda MBO, as EBO nuk u zbatuan në tërë kuptimin e tyre. Ndërmarrjet ju shitën punonjësve, por vetëm në copa.

Shitja direkte punonjësve ose drejtuesve (këtyre të fundit në shumë pak raste) nuk përfshiu shitjen e një ndërmarrjeje të plotë. Nga kjo pikëpamje është logjike të konsiderojmë M/EBO thjesht si një shitje direkte.

Gjithashtu, dhe ish-pronarët si një grup kishin të drejtën të merrnin pjesë në shitjen direkte të njësive të shërbimit të tregtisë. Favorizimi i punonjësve dhe i ish-pronarëve ishte në përputhje me kriterin e "drejtësisë sociale" të procesit të privatizimit.

Nga fundi i vitit 1991, privatizimi me anë të shitjes direkte u përdor në të gjithë vendin dhe në të gjitha shërbimet e tregtisë, si dyqane shitjeje dhe riparimi, taksitë, sistemi interurban, automjete të vogla, ofiçina riparimi automjetesh, berberë, rrobaqepës, këpucarë, bar-restorante, makineri bujqësore etj., etj..

Në fillim të procesit të privatizimit shteti nuk i kushtoi rëndësi të ardhurave nga privatizimi. Punonjësit i blenë objektet me çmime shumë të ulta, përderisa në duart e popullatës në atë kohë nuk kishte para.

Në fillim të vitit 1993 tre gjëra u bënë të qarta:

1. Shteti nuk mund ta privatizonte pronën e tij shumë lirë për një kohë të gjatë, kur ishte e mundur të kishte çmime më të mira shitjeje.
2. "*Know-how*" i blerësve nuk mjaftonte për të vazhduar një biznes. Atyre, menjëherë mbas blerjes, u nevojiteshin likuiditete të konsiderueshme.
3. Ish-pronarët e trojeve dhe ndërtesave nuk ishin të kënaqur nga procesi. Ata kërkonin rikthimin e pasurive të tyre.

Prandaj, duke filluar nga mesi i vitit 1993, u pa e nevojshme të futeshin metoda të tjera privatizimi.

Shitja direkte ishte pak a shumë privatizim në shkallë të vogël në Shqipëri. Për këtë arsye, procesi që lidhet me këtë metodë mund të quhet "procesi i privatizimit të vogël (PPV)".

Procesi PPV dhe rezultatet e tij

Procesi i privatizimit të vogël filloi në prill të vitit 1991, por grevat e gjata dhe situata politike në atë kohë bllokoi tërë ekonominë shqiptare dhe privatizimin. Vetëm fare pak objekte u privatizuan nga ministritë e linjës në prill-qershor të vitit 1991.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 307, datë 29.08.1991 u krijuan AKP (Agjencia Kombëtare e Privatizimit) dhe KPPP (Komiteti Përgatitor i Përgatitjes së Privatizimit) si institucionet përgjegjëse për ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Qysh në fillim Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe Komiteti Përgatitor i Përgatitjes së Privatizimit vendosën të bëjnë një privatizim me shpejtësi të lartë, veçanërisht pas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 10.08.1992 "Për një ndryshim

në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 25.06.1992 "Për rinisjen e procesit të privatizimit." Ky vendim e bëri metodën e shitjes direkte punonjësve si metodën bazë të privatizimit të njësive të tregtisë me pakicë, të shërbimeve publike dhe artizanale, të automjeteve (përveç transportit urban) traktorëve dhe makinerive bujqësore. Vetëm në rastet kur punonjësit nuk donin t'i blinin objektet, shiteshin në ankand.

Gjatë viteve 1991-1992 u privatizuan rreth 12000 dyqane, 5000 njësi të vogla të shërbimit të tregtisë dhe 2000 automjete, anije peshkimi, makineri bujqësore etj.. Ky privatizim u krye nëpërmjet shitjes së dyqaneve atyre që punonin në to, me një çmim që llogaritej në bazë të vlerës kontabël të mbetur, vlerës së ndërtimit dhe/ose vlerës së instalimit të pajisjes. Gjithashtu, gjatë kësaj faze u privatizuan një numër i madh klinikash dentare dhe farmacish.

Pagesa duhej bërë vetëm me para në dorë.

Në vitet 1991-1992 vlera mesatare e transaksioneve ishte afërsisht 300 usd. Kjo vlerë e ulët transaksionesh nuk ishte gjithmonë tregues i gjendjes së dobët të aktiveve. Në të vërtetë pjesa më e madhe e njësive të tregtisë iu shit shumë lirë nga shteti njerëzve, që në atë kohë kishin shumë pak para në dorë.

Pas një pauze të gjatë, shitja direkte punonjësve rifilloi pas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 03.05.1995, "Mbi privatizimin e SME", deri në fillim të vitit 1997 (periudhë mbas të cilës shitja direkte u ndërpre). Në këtë kohë, punonjësit kishin të drejtën të blinin vetëm automjetet, makineritë dhe pajisjet e caktuara për t'u privatizuar veçmas.

Pagesa në këtë fazë të PPV bëhet:

1. në para;
2. në lekë privatizimi;
3. në bono privatizimi pas qershorit të vitit 1995.

Në fillim të vitit 1998, bazuar në paketën e re të akteve ligjore dhe nënligjore mars - prill 1998, për privatizimin e ndërmarrjeve dhe të njësive të shkëputura jostrategjike, shitja është kryer vetëm në lekë dhe nëpërmjet ankandit, përveç shitjes me bono/lekë privatizimi të objekteve për të cilat procedurat kishin filluar gjatë vitit 1997.

Ankandi dhe tenderi publik

Aspekte të përgjithshme

Ankandi publik është metoda e privatizimit për transferimin e të drejtave të pronësisë pronarit privat nëpërmjet ofertave konkurruese të hapura. Duke transferuar të drejtat e pronësisë, shteti çlirohet nga rreziku financiar dhe ekonomik dhe nëse ndërmarrja prodhon humbje ky është një problem i pronarit të ri privat.

Ankandi publik mund të konsiderohet metoda kryesore e privatizimit e përdorur në Shqipëri. Ajo është metoda më e rëndësishme e përdorur në terma të njësisive të privatizuara, totalit të të ardhurave nga privatizimi, shpërndarjes gjeografike dhe sektorëve ekonomikë të përfshirë.

Kuadri ligjor mbi të cilin ka qenë bazuar ankandi publik ka lejuar mjaft raste përjashtimi nga ankandi real, saqë e bën këtë metodë të duket më shumë si një proces sesa thjesht një instrument për transferimin e të drejtave të pronësisë. Ligjërisht, kushtet e veçanta kanë konsistuar në përjashtimin nga ankandi të disa grupeve ose individëve të favorizuar, si ish-pronarët, punonjësit dhe njerëz të tjerë "me merita të veçanta". Sipas përkufizimeve teorike këto përjashtime duhen konsideruar si shitje direkte.

Ankandi ka qenë një instrument për transferimin e të drejtave të pronësisë në metodën e ankandit publik, metodën e privatizimit masiv dhe metodën e investitorit strategjik.

Ankandi publik u përdor fillimisht si metoda e privatizimit të SME (shpesh i quajtur edhe privatizimi i SME), por më vonë ai u përdor edhe për privatizimin e disa ndërmarrjeve relativisht të mëdha.

Procedurat dhe rregullat e mëposhtme për ankandin publik janë miratuar me akte ligjore përkatëse:

1. Ish-pronarët e truallit kishin të drejtën e parablerjes së ndërmarrjes ose të pjesëve të saj, nëse më shumë se 80 për qind e truallit të ndërmarrjes ose objektit ishte ndërtuar mbi pronën e tyre.
2. Detyrimet kontraktore me palët e treta lidhur me prodhimin ose shërbimet duhet të respektohen nga pronarët privatë.

3. Ndërmarrjet e sapoprivatizuara ndaloheshin të ndryshonin destinacionin e biznesit të paktën për dy vjet, pa lejen e AKP. Ky kriter shpesh nuk u respektua nga pronarët e rinj.

4. Gjatë procesit të privatizimit të ndërmarrjes, ndërmarrjet e mëdha mund të copëtoheshin në pjesë ose në njësi më të vogla (fragmentimi i ndërmarrjeve) me qëllim që të rritnin shanset e tyre për privatizim dhe mbijetesë.

5. Gjatë procesit të privatizimit pushtetit lokal, institucioneve publike, agjencive shtetërore ose ndërmarrjeve shtetërore ju ndalohej blerja e ndërmarrjeve dhe/ose objekteve.

6. Publikimi i objekteve dhe i njërive për t'u privatizuar ishte shumë i rëndësishëm. Ligji detyronte procedura të qarta publikimi, duke siguruar informacion dhe transparencë për këdo që ishte i interesuar për njësitë që do të privatizoheshin. Vetëm në raste tepër të veçanta një objekt, që ishte publikuar për privatizim, mund të tërhiqej nga procedurat e privatizimit nga AKP ose nga Këshilli i Ministrave.

Rastet e shitjes direkte kufizoheshin vetëm për pronarët e truallit dhe punonjësit. Punonjësit kishin të drejtën të blinin makineri të veçuara, objekte me vlefte të ulta ose automjete.

Në gjysmën e dytë të vitit 1995, filloi zbatimi i programit të privatizimit masiv (PPM), i cili ja zbehu disi rëndësinë ankandit publik, por në asnjë mënyrë nuk e bëri një metodë sekondare. Statistikat tregojnë, se të ardhurat nga ankandi i objekteve dhe i ndërmarrjeve të privatizara (gjithsej 98 ndërmarrje shtetërore të transformuara më parë në shoqëri tregtare) gjatë vitit 1995-1996 janë më të mëdha se vlera e ndërmarrjeve të privatizuara me metodën e privatizimit masiv (MPM).

Në verën e vitit 1995, filloi shpërndarja e bonove të privatizimit si pjesë e programit të privatizimit masiv. Bonot e privatizimit u lejuan të përdreshin në ankandet publike njëlloj si lekët e privatizimit të ish - të përndjekurve politikë.

Gjatë vitit 2000, krahas zbatimit të formave të privatizimit me ankand publik, është përdorur dhe privatizimi me shitje nëpërmjet tenderit të hapur, duke shitur paketat e aksioneve shtetërore një investitori strategjik, përveç paketave që u janë transferuar ish-pronarëve dhe punonjësve pa ankand.

Realizimi i procesit të privatizimit me shitje direkte dhe nëpërmjet ankandit publik apo tenderit të hapur, me shifra, paraqitet ndër vite si më poshtë:

Pasqyra e privatizimit me shitje direkte dhe ankand/tender.

milione lekë

Viti	Nr.objek.	Lekë	Lekë privatizimi	Bono privat.	Vlefte totale
1991-1992		537.9	537.9
1993	3,268	4,477.0	4,477.0
1994	2,775	1,838.0	341.1	...	2,182.1
1995	2,924	597.2	2,704.3	828.0	4,129.5
1996	2,248	314.5	784.1	2,407.3	3,505.9
1997	717	185.1	69.6	747.8	1,002.5
1998*		258.8	13.2	358.8	630.8
1999		1,027.4	1,027.4
2000		2,168.4	2,168.4
2000(9 muj)		844.4	844.4

* Për privatizimet në vitet 1998-2001 me shitje me ankand vetëm me lekë, dhe në strukturën e shitjeve përfshihen objekte, makineri, kuota dhe paketa shtetërore. Për periudhën 1998-2001 vlerësohen të shitura 179 objekte tërësore dhe 183 objekte pjesore. Privatizimi me tender të hapur është përdorur për 3 shoqëri dhe 1 ndërmarrje shtetërore.

Ndryshe nga metodat e tjera të privatizimit shitja direkte dominohet nga pagesa në para, e cila rezulton në përqindjen më të lartë (83%) të të gjitha të ardhurave. Kjo shpjegohet me faktin se kur hynë në funksionim lekët e privatizimit dhe bonot (mbas vitit 1995), shitja direkte u zëvendësua nga ankandi publik.

Metoda e privatizimit masiv

Aspekte të përgjithshme

Metoda e privatizimit masiv (MPM) është metoda sipas të cilës njerëzit blejnë aksione të kompanive shtetërore në shkëmbim të bonove të privatizimit që ata zotërojnë.

Kështu metoda e privatizimit masiv ndjek parimin:

'Shpërndarje e pasurisë tek ata që kanë kontribuar në krijimin e saj'.

Impaktet që priteshin nga zbatimi i metodës së privatizimit masiv janë:

1. Krijimi i një klase të gjerë të pronarëve të rinj, për të nxitur "kapitalizmin popullor" nëpërmjet një shpërndarjeje të gjerë të pronësisë. Në këtë mënyrë, ajo synonte inkurajimin dhe mbështetjen e shtresave të gjera për gjithë procesin e privatizimit.
2. Shpejtësi e lartë e transferimit të të drejtave të pronësisë nga shteti tek aksionerët privatë.
3. Kjo metodë e bën të mundshme privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha pa i ndarë ato në pjesë më të vogla.
4. Indirekt, ajo duhej të nxiste zhvillimin e tregjeve të kapitalit; krijimin e një kulture dhe mentaliteti të ri për bashkëpronësinë.

Në kuadrin e programit të privatizimit masiv, të gjitha ndërmarrjet i nënshtrohen paraprakisht transformimit në shoqëri tregtare në formën e shoqërive aksionere shtetërore. Metoda e privatizimit masiv është zbatuar deri tani për privatizimin e 98 ndërmarrjeve. Zbatimi i kësaj metode në Shqipëri pati këto karakteristika:

- zotëruesit e bonove të privatizimit mund t'i përdornin këto bono për të blerë aksione të ndërmarrjeve pa nevojën e ndërmjetësve të tjerë financiarë;
- bonot e privatizimit ishin të tregtueshme në tregun e lirë. Investitorët e huaj nuk morën pjesë në privatizimin e shoqërive me bono privatizimi për shkak të kufizimeve ligjore. Që prej nëntorit të vitit 1996 u lejua edhe pjesëmarrja e të huajve në privatizimin masiv;
- procesi i ankandit për aksionet e shoqërive nuk u bazua në një çmim të llogaritur paraprakisht të aksioneve domethënë, të gjithë blejnë të gjitha aksionet;
- ekzistenca dhe veprimtaria aktive e tregut të lirë të bonove praktikisht, përjashtoi përdorimin direkt të parave (*cash*) për privatizimin e ndërmarrjeve me metodën e privatizimit masiv. Çdokush mund të blinte lirshëm bono privatizimi në treg me një çmim shumë më të ulët se vlera e tyre nominale, për të blerë pastaj aksionet e SH.A. që do të privatizoheshin me metodën e privatizimit masiv me vlerën e tyre nominale.

Transferimi i aksioneve nëpërmjet ankandit publik në Shqipëri është e vetmja mënyrë e zbatuar deri tani.

Baza ligjore

Zbatimi i metodës së privatizimit masiv u mbështet nga një bazë ligjore specifike.

Ligji nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)".

Ndërmarrjet përpara privatizimit me metodën e privatizimit masiv, u transformuan në shoqëri tregtare, me bazën ligjore përkatëse.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 14.08.1995 "Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare", përcaktoi të gjitha procedurat për transferimin e aksioneve të Sh.A.-së gjatë zbatimit të programit të privatizimit masiv.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 30.10.1995 "Për transferimin e aksioneve të shtetit personave pjesëmarrës në ankandet e shoqërive tregtare shtetërore", rregulloi procedurat e transferimit të aksioneve të Sh.A.ve tek pjesëmarrësit në ankand, sipas rezultateve përfundimtare të çdo ankandi të nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Fondet e investimeve në Shqipëri

Sipas përcaktimit në legjislacionin shqiptar "Fond investimi" mund të ishte çdo person juridik privat, që duke akumuluar burimet financiare të personave fizikë a juridikë (letrat me vlerë të privatizimit, bono privatizimi, para në dorë);

- emeton vetëm aksionet e tij në këmbim të tyre;
- investon, riinveston, zotëron ose tregton letrat me vlerë.

Një fond investimesh themelohet dhe organizohet si shoqëri anonime në përputhje me legjislacionin shqiptar. Ai është një shoqëri me një numër të madh pronarësh dhe që vetëm në fillim angazhohet në grumbullimin e bonove të privatizimit dhe përdorimin e tyre për blerjen e aksioneve të shoqërive që do të privatizoheshin. Në Shqipëri zotëruesve të bonove ju ofrua mundësia të investonin në një fond investimesh, vetëm bono privatizimi. Ndërsa me para në dorë mund të investonin vetëm në raste të veçanta, të parashikuara në ligj.

Fondet e investimeve të bonove luajnë rolin e ndërmjetësve financiarë nëpërmjet shkëmbimit të bonove të privatizimit të mbledhura nga popullsia, me aksione të shoqërive që do të privatizohen me metodën e privatizimit masiv. Në këtë mënyrë, teorikisht pozicioni i tyre ishte i vendosur qartë në akumulimin dhe ndërmjetësimin e bonove të privatizimit. Si të tilla ato mund të bëheshin pjesë integrale e gjithë programit të privatizimit masiv.

Fondet e investimeve ofrojnë tek investuesit mundësinë për të marrë pjesë në tregun e aksioneve pa qenë nevoja që të kenë njohuritë e nevojshme për to. Në këtë mënyrë, fondet e investimeve shpërndajnë rrezikun e zotëruesve të aksioneve duke vepruar si fonde të përbashkëta.

Themelimi i fondeve të investimeve në Shqipëri, është i bazuar në ligjin nr. 7979 datë 26.07.1995 "Për fondet e investimeve".

Statuti i një fondi investimesh kërkohet të jetë në përputhje me statutin tip të fondeve të investimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ministri i Financave ishte caktuar si autoriteti rregullues i fondeve të investimeve.

Në regjistrin tregtar të Shqipërisë u regjistruan tre fonde investimesh:

- Fondi investimeve "Anglo-Adriatika" në Tiranë;
- Fondi investimeve "Shqipëria e Re" në Tiranë;
- Fondi investimeve "Nobel" në Tiranë.

Fondi i investimeve "Nobel" mori vetëm licencën e përkohshme. Ky fond nuk zhvilloi më tej veprimtari kështu që, sipas legjislacionit shqiptar, veprimtaria e tij u konsiderua e mbyllur. Ndërsa fondi investimeve "Anglo-Adriatika" dhe fondi investimeve "Shqipëria e Re" morën licencën e përhershme.

Fondi i investimeve "Shqipëria e Re" mori këtë licencë në dhjetor të vitit 1996, por veprimtaria e fondit mbeti pa u zhvilluar për shkak të situatës së krizës në Shqipëri gjatë vitit 1997 dhe më pas veprimtaria e këtij fondi u mbyll.

Fondi i investimeve "Anglo Adriatik" (FIAA) u licencua në maj të vitit 1996. Deri në pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë së tij (shkurt-mars 1997) për shkak të situatës së krizës në Shqipëri, ky fond numëronte 41,182 "bonodhënës". FIAA kishte në plan të investonte në sektorë të emërtuar "sektorë strategjikë" si telekomunikacioni, hidroenergjitika, burimet minerare dhe përpunuese, turizëm, materiale ndërtimi etj..

Strategjia që ndoqën vetë fondet e investimeve, për të investuar në sektorët strategjikë, shkaktoi një vonesë të gjatë për përfshirjen konkrete të tyre në procesin e privatizimit.

Njëkohësisht, ekzistenca e tregut të lirë të bonove praktikisht krijoi një paralelizëm midis, fondeve të investimeve si subjekte që duhet

t'i nënshtrohen shumë kufizimeve nga njëra anë, dhe institucioneve ose personave, të cilët nuk kishin asnjë kufizim për të grumbulluar dhe për të investuar bonot e privatizimit, nga ana tjetër.

Gjithashtu, procedura e ankandit për transferimin e aksioneve pa një çmim të paralogaritur të tyre, bëri që fondet e investimeve të frenoheshin në përfshirjen e tyre, sepse ato nuk mund të përcaktonin numrin e aksioneve për të cilat ato duhej të investonin (sipas ligjit ato s'duhet të kalojnë 40 për qind të aksioneve të Sh.A.-së).

Sidoqoftë, është fakt që fondet e investimeve nuk luajtën ndonjë rol në procesin e privatizimit në Shqipëri.

PROCESI I METODËS SË PRIVATIZIMIT MASIV

Nga muaji maj 1995 deri në fillim të vitit 1997 u privatizuan, me metodën e privatizimit masiv 97 ndërmarrje, që paraprakisht u transformuan në shoqëri aksionere shtetërore. Ato i përkisnin sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si industria mekanike, industria e përpunimit të ushqimeve, industria kimike, industria e lehtë dhe tekstile etj..

Është për t'u përmendur që SH.A. shtetërore, që u privatizuan me metodën e privatizimit masiv, nuk i përmbushnin të gjitha kriteret për të qenë shoqëri tregtare. Përzgjedhja e këtyre shoqërive ishte pika më e dobët në zbatimin e metodës së privatizimit masiv në Shqipëri; për më tepër në proces u përfshinë edhe shoqëri me vlerë negative të aktiveve.

Procedura e ankandit të aksioneve nuk u bazua në ndonjë çmim të paralogaritur sipas të cilit oferta dhe kërkesa për aksione të shoqërisë, që do të privatizohej, shkojnë gjithnjë paralelisht, domethënë, të gjitha bonot blejnë të gjitha aksionet. Gjithashtu, mungoi dhe informacioni rreth ecurisë së shoqërive, situatës së tyre ekonomiko-financiare dhe planet perspektive të zhvillimit të tyre. Kështu që kërkuesit e aksioneve nuk kishin asnjë ide për Sh.A.-në për të cilën ata ofronin bonot e privatizimit për të marrë aksione të saj.

Privatizimi i shoqërive, me anë të metodës së privatizimit masiv, krijoi shoqëri me një numër të madh aksionerësh. Kjo situatë krijoi shumë probleme për më të shumtën e shoqërive të privatizuara

sepse aksionerët kishin mangesi në njohjen e të drejtave dhe të detyrimeve si aksionerë dhe për administrimin.

Rezultatet

Në privatizimin e shoqërive me anë të metodës së privatizimit masiv u përfshinë 97 shoqëri të sektorëve dhe degëve të ndryshme të ekonomisë shqiptare, të cilat paraqiten në tabelën më poshtë:

Shpërndarja sipas sektorëve të Sh.A.-ve të privatizuara me metodën e privatizimit masiv.

Nr	Sektori Ekonomik	Nr. i Shoqërive
1.	Përpunimi ushqimor	13
2.	Ndërtim & Materiale ndërtimi	12
3.	Mekanike	12
4.	Shërbime & Tregti	9
5.	Të përziera	7
6.	Transporti	6
7.	Tipografia	6
8.	Druri & Letra	6
9.	Kimike & Industria plastike	5
10.	Tekstilet & Veshjet	5
11.	Energjitika	4
12.	Bujqësia	3
13.	Turizmi	3
14.	Prodhimi artizanal	2
15.	Nafta & Gazi	2
16.	Lëkura	1
17.	Miniera	1
	TOTALI	97

Pasqyra e privatizimit me anë të programit të privatizimit masiv . në milionë lekë

Viti	No. obj.	Lekë	Lekë privatizimi	Bono privatizimi	Vlefte totale
1991-1992					
1993					
1994					
1995	50	...	450.0	1,703.0	2,153.0
1996	47	...	311.7	2,873.2	3,184.9

Si përfundim, mund të thuhet se metoda e privatizimit masiv në Shqipëri u zbatua në bazë të një vendimi politik, pa marrë në konsideratë parakushtet për suksese në rezultate, sepse, në fakt nuk ekzistonte, si oferta (shoqëritë që mund të privatizoheshin me metodën e privatizimit masiv) ashtu edhe mentaliteti i

njerëzve për të qenë aksionerë. Metoda e privatizimit masiv u zbatua sipas rekomandimeve këmbëngulëse të institucioneve të mëdha ndërkombëtare, pa marrë parasysh gjendjen specifike social - ekonomike, në të cilën Shqipëria ishte dhe vazhdon të jetë.

PRIVATIZIMI I SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË (STRATEGJIKË)

Aspekte të përgjithshme

Viti 1999 mund të përcaktohet si viti i përfundimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve dhe shoqërive të vogla dhe të mesme, dhe fillimi i procesit të privatizimit të sektorëve strategjikë. Procesi i privatizimit në sektorët strategjikë, realizohet në përputhje me strategjinë e privatizimit, të miratuar me ligjin nr.8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë". Në bazë të këtij ligji, privatizimi i shoqërive që operojnë në sektorët strategjikë kryhet me ligje të veçanta, me asistencë ndërkombëtare dhe i drejtuar nga një komitet transparence dhe konsulence. Ky komitet drejton të gjithë procesin e privatizimit, kryesohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe përbëhet nga anëtarë të emëruar prej tij nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të ministrive të linjës administrative (në varësi të shoqërive që privatizohen), përfaqësues të konsulentit ndërkombëtar dhe të donatorëve (në këtë rast të Bankës Botërore). Për çdo shoqëri përpunohet dhe miratohet një kuadër i veçantë rregullash proceduralë dhe aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat duhet të përcaktojnë formën, formulën e privatizimit dhe udhëzimet e tjera të nevojshme.

Procesi i privatizimit të sektorëve strategjikë përbën momentin më të rëndësishëm të reformës ekonomike për faktin që ai shtrihet në dimensione shumë të mëdha politike, sociale dhe ekonomike, prej të cilit priten efekte pozitive esenciale në tregjet e kapitaleve, të mallrave, financiare dhe të punës.

Programi i privatizimit të sektorëve më të rëndësishëm përfshin afro 75 për qind të aseteve të ekonomisë, në sektorët e naftës dhe të gazit, të sistemit elektroenergjetik, të telekomunikacionit, të infrastrukturës së transportit, të minierave dhe burimeve ujore dhe të sistemit të shpërndarjes së ujit.

Aktualisht, njësitë ekonomike që veprojnë në disa nga këta sektorë janë në gjendje mjaft të vështirë:

- me teknologji të prapambetur dhe me gjendje teknike të ulët, si pasojë e mungesës së investimeve të reja në këta sektorë për një periudhë mjaft të gjatë kohore;
- me fuqi të tepërt punëtore;
- të bllokuar në treg dhe me gjendje të lartë debitore;
- me nivel të ulët administrimi, planizim inadeguat aktual dhe perspektiv, ndërhyrje të theksuar të shtetit në veprimet e përditshme, njohje të cekët të ligjeve dhe të rregullave të tregut;
- me mungesë kapaciteti për të administruar situatat e krizës dhe pamundësi për të falimentuar;
- me nivel të ulët të disiplinës financiare, sisteme inadeguate të matjes dhe kontrollit,
- me objektiva të paqartë, të shumëfishtë (pa kahje) dhe konfliktuale;
- nën patronazhe politike që nuk lejojnë një veprimtari eficiente të shoqërive.

Në përgjithësi, këta sektorë janë monopole natyrale dhe unike në veprimtarinë ekonomike të vendit tonë, lidhur me produktet dhe me shërbimet që kryejnë.

Gjendja e rëndë në këta sektorë kërkon ndërhyrje cilësore rishtrukturoese, derregulluese nëpërmjet enteve rregullatore dhe privatizuese për rikapitalizim, nëpërmjet investimeve në vlera të mëdha të papërbalueshme, të cilat kërkojnë tërheqjen e kapitaleve të huaja private për të riaktivizuar dhe për të përdorur me efektivitet, burimet natyrore dhe njerëzore të këtyre sektorëve.

PROCESI I PRIVATIZIMIT

Rishtrukturuimi dhe privatizimi i shoqërive të sektorëve me rëndësi të veçantë për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare paraqitet tepër kompleks, duke patur parasysh shkaqet e mësipërme të ineficiencës ekonomike të tyre dhe do të shoqërohet patjetër me probleme sociale dhe ekonomike.

Procesi i privatizimit të shoqërive të sektorëve me rëndësi të veçantë për ekonominë, në parim do të realizohet me investitor strategjik, të cilit do t'i transferohet e drejta shtetërore (e përdorimit, zhvillimit apo e pronësisë) e të gjithë shoqërisë ose paketa kontrolluese e aksioneve.

Dy janë arsyet kryesore të kësaj zgjidhjeje:

1. Ndërmarrjet apo shoqëritë tregtare shtetërore kanë nevojë për teknologji të re, *know-how*, financime të reja dhe administrim të aftë.
2. Ndërmarrjet apo shoqëritë tregtare shtetërore në gjendje të vështirë financiare dhe administrim jo të përshtatshëm, mund ta transformojnë këtë situatë vetëm duke kaluar tek një investitor privat me përvojë në fushën përkatëse dhe i fuqishëm financiarisht.

Për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave që përcakton programi i qeverisë në marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, për privatizimin e sektorëve strategjikë, punohet në bashkëpunim me ministrinë dhe drejtorinë e linjës dhe me asistencë ndërkombëtare të një grupi kompanish italiane, në fushën ligjore, teknologjike dhe financiare. Në këtë kuadër, po zbatohet projekti "Five Stars", i cili përfshin pesë kompani të sektorëve strategjikë : **AMC, Albtelekom, Albakrom, Albbakër dhe Albpetrol**. Për privatizimin e tyre, me asistencën e kompanisë konsulente ndërkombëtare, janë përgatitur programe të detajuara.

1- PËR SEKTORIN E TELEKOMUNIKACIONEVE

Aktualisht, sektori i telekomunikacioneve përfshin aktivitetet e shoqërive tregtare shtetërore të "Albtelekom" sh.a. dhe të shoqërisë anonime AMC .

Albtelekom Sh.a. kryen shërbimet e rrjetit telefonik fiks publik, duke mbuluar telefoninë bazë lokale, ndërrurbane dhe ndërkombëtare; komunikim të dhënash kombëtare dhe ndërkombëtare; shërbimet teleks; telefona me monedhë, me kartë dhe me kartë kredit si dhe radiokomunikacion detar.

Shoqëria anonime AMC kryen shërbimin e telefonisë celulare në një zonë prej rreth 25 për qind të territorit të vendit, ku përfshihet rreth 50 për qind e popullsisë së vendit.

1. NË SEKTORIN E TELEKOMUNIKACIONEVE

AMC Sh.a. është kompania e parë e sektorit strategjik që ju nënshtrua privatizimit.

Privatizimi i kësaj shoqërie u realizua në korrik të vitit 2000, nëpërmjet një kontrate shitjeje të një pakete aksionesh prej 85 për

qind. Në sektorin e telefonisë celulare ku operon AMC është licencuar edhe një operator i dytë.

Albtelekom Sh.a Në bashkëpunim me konsulentin ndërkombëtar është programuar fillimi i procedurave të tenderave brenda vitit 2001 dhe realizimi i kontratës brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2002.

2- PËR SEKTORIN ELEKTROENERGJITIK

Sistemi elektroenergjitik në Republikën e Shqipërisë është një sistem unik, i cili përbëhet nga tre hallka kryesore (prodhimi, transmetimi, shpërndarja) dhe përfaqësohet nga Koorporata Energjitike Shqiptare - KESH sh.a. dhe 3 kompani pilot të shpërndarjes së energjisë elektrike në Vlorë, Shkodër dhe Elbasan. Sistemi elektroenergjitik ka fuqi të instaluar 1656 MW nga të cilat, 1460 MW me HEC-e dhe 196 MW me TEC-e. Prodhon rreth 3,6 miliardë Kwh në vit me 90 për qind siguri. Deri tani KESH ka kryer hapin e transformimit në shoqëri aksionere sh.a., duke u konsoliduar organizativisht.

Procesi i privatizimit të KESH-it do të kalojë në këto faza:

Sipas propozimeve të Bankës Botërore dhe BERZH-it janë përpunuar termat e referencës për "Asistencë për administrimin e KESH-it" nga një kompani e huaj, e cila pritet të përzgjidhet brenda tremujorit të parë të vitit 2000. Për vazhdimin e procesit të ristrukturimit po kryhet studimi për ndarjen e KESH-it në dy kompani:

- e para: KESH - prodhim dhe transmetim;
- e dyta: shpërndarja, e cila do të ketë emërtim tjetër.

Njëkohësisht është kryer ristrukturimi i KESH për ndarjen e hidrocentraleve lokale nën 2 MW dhe për privatizimin e tyre sipas ligjit nr.8527, datë 23.09.1999 "Për privatizimin e hidrocentraleve vendore". Privatizimi i HEC-e lokalë me fuqi 2MW, po realizohet në mënyrë të pavarur nga privatizimi i sektorit elektroenergjetik, duke bërë rregullimet ligjore të nevojshme dhe duke përdorur kontrata koncensionare apo shitjen nëpërmjet ankandit.

Për tre shoqëritë pilot, pjesa shtetërore (që përbën 70 për qind të aksioneve të secilës shoqëri) është transferuar në KESH, i cili do t'i administrojë ato shoqëri.

3- PËR SEKTORIN E NAFTËS DHE TË GAZIT

Aktiviteti në fushën e naftës dhe të gazit ka qenë ushtruar nga **Albpetrol sh.a.** që përfshinte kërkim-nxjerrjen, përpunim-marketingun dhe disa filiale të shërbimeve speciale. Situata financiare e rënduar, teknologjia e vjetëruar, ambjenti i një konkurrence jolegale në marketing si dhe pamundësia për shitblerjen e aksioneve në tregjet financiare brenda dhe jashtë vendit, e kishin futur Albpetrolin në një krizë të thellë nga viti në vit duke vështirësuar edhe shanset për privatizim.

Në këto kushte procesit të privatizimit i parapriu një proces ristrukturimi organizativ dhe operacional, me ndarjen dhe krijimin e 4 shoqërive:

- APC (Albanian Petroleum Corporation) sh.a., si shoqëri holdingu, aksionet e së cilës i janë transferuar shoqërive të kontrolluara;

- SERVCOM sh.a. për shërbimet speciale;

- ARMO sh.a. për përpunim-marketingun;

- ALBPETROL sh.a. për kërkim-nxjerrjen.

Ristrukturimi organizativ është shoqëruar edhe me ristrukturimin e burimeve njerëzore.

Gjatë zbatimit të procesit u përgatitën dhe u miratuan akte ligjore dhe nënligjore për përshpejtimin e procesit të privatizimit dhe për mbështetjen e ristrukturimit të mëtejshëm.

Për "Servcom" Sh.a. Fier

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 07.07.2000 "Për njësitë e shoqërisë "Servcom" Sh.a. që nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë" ka filluar ristrukturimi i "Servcom" Sh.a. Fier . Në këtë kuadër kanë dalë urdhrat e ministrit për miratim privatizimi për Njësitë e Zbatimit të Investimeve në Patos dhe Sizmikës Fier, dhe të aseteve të shkëputura. Procedura e privatizimit realizohet sipas akteve ligjore për sektorët jostrategjikë (ndërmarrje dhe shoqëri të vogla e të mesme).

Në zbatim të ligjit nr. 8707, datë 24.01.2001 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Servcom", u përgatit dhe doli vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 27.05.2001 "Mbi fillimin e procesit të privatizimit të shoqërisë anonime "Servcom" Fier dhe përcaktimi i formës dhe i strukturës së formulës së privatizimit". Me daljen e këtij vendimi ka filluar ristrukturimi i mëtejshëm i shoqërisë, organizativ, operacional dhe i burimeve njerëzore.

Procesi i privatizimit parashikohet të përfundojë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2002.

Për "Armo" Sh.a. Fier:

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.500, datë 21.09.2000 "Për njësitë e shoqërisë "Armo" Sh.a., që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë" është realizuar ristrukturimi organizativ dhe operacional duke shkëputur nga sektori strategjik 28 njësi të kësaj shoqërie për ristrukturimin e saj. Për këtë shoqëri është miratuar edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.489, datë 14.08.2001 "Disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.500, datë 21. 09.2000 "Për njësitë e shoqërisë "Armo" Sh.a., që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë". Aktualisht, është në përfundim puna për përgatitjen e dosjeve të privatizimit të këtyre njësive nga ana e "Armo" Sha Fier.

Privatizimi ka filluar në shoqërinë Armo Sh.a. me kalimin në përdorim të pikave të shitjes së karburanteve tek subjektet private, kryesisht ish-punonjësve të saj.

Për "Albpetrol" Sh.a. Fier:

Është punuar për përfundimin e programit të punës për evidentimin e aseteve të shoqërisë, të cilat do t'i propozohen Këshillit të Ministrave për t'u hequr nga sektori strategjik.

Për "Uzinën Mekanike të Naftës" Kuçovë:

Është përgatitur projektligji "Për formën dhe strukturën e formulës së privatizimit të "Uzinës Mekanike të Naftës" Kuçovë.

4-PËR SEKTORIN E MINIERAVE

Në këtë sektor kryejnë aktivitetin e tyre shoqëria aksionere **Albkrom sh.a.**, **Albbakër sh.a.** dhe disa miniera të tjera si ato të qymurgurit, të hekurnikelit, të nikelsilikatit, të boksiveve etj..

Për zhvillimin e këtij sektori, me interes të veçantë duken format e transferimit të së drejtës për shfrytëzim dhe të së drejtës për zhvillim, duke përdorur të gjitha format e mundshme për të tërhequr kapitale të huaja, si projektet me vetëfinancim dhe format e ndryshme koncensionare. Në sektorin minerar privatizimi do të synonte riaktivizimin e industrisë minerare dhe rritjen e efektivitetit

të saj për të siguruar një shfrytëzim më intensiv të këtyre pasurive nëntokësore.

Industria e kromit

Industria e kromit përbëhet nga prodhimi, pasurimi, shkrirja e kromit dhe marketingu. Kjo industri përfaqësohet nga Albkromi SH.a.. Pas vitit 1990 prodhimi i kromit ka rënë ndjeshëm, nga mbi 1 milion ton në vit në 0.24 milionë tonë. Në këto kushte, situata ekonomiko-financiare dhe teknike paraqitej e rënduar.

Për "Albkrom" Sh.a.

Privatizimi i Albkromit është realizuar në bazë të një programi të detajuar fillimisht me ristrukturimin dhe në vazhdimësi me privatizimin e asetëve të atyre sektorëve, që me vendim të Këshillit të Ministrave janë hequr nga sektori strategjik. Po punohet për përshpejtimin e këtij procesi.

Ndërsa pjesa tjetër strategjike, gjatë viteve 2000 - 2001 është privatizuar me kontrata koncensionare, ndërmjet MEPP dhe Shoqërisë të së Drejtës Italiane "Darfo" S.p.a.

Për "Albbakër" Sh.a.

Për të gjithë ata sektorë të "Albbakër" që me vendim të Këshillit të Ministrave janë hequr nga sektori strategjik, janë nxjerrë urdhrat e ministrit për miratim privatizimi dhe po punohet për përgatitjen e dosjeve të privatizimit. Me miratimin në Parlament të ligjit "Për miratimin e dhënies me koncension të disa objekteve të industrisë së bakrit dhe të kromit", me firmën turke "BEN-ONER" u përgatit programi i punës për të realizuar procesin e dorëzimit.

Industria e bakrit

Kjo industri përfshin nxjerrjen, përpunimin, shkrirjen dhe marketingun e mineralit të bakrit dhe përfaqësohet nga Albbakër sh.a., i cili është në vështirësi të mëdha financiare dhe me probleme tekniko- teknologjike.

5-PËR SEKTORIN E TRANSPORTIT

Në sektorin e transportit do të trajtohen si strategjike transporti ajror, sektori i porteve dhe ai hekurudhor.

Në sektorin e transportit ajror kryejnë aktivitet **Ndërmarrja e Albrtransportit dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA)**. Procesi i privatizimit mendohet të realizohet nëpërmjet kalimit të së drejtës së shfrytëzimit apo të së drejtës së zhvillimit dhe do të kalojë në këto stade:

- transformimi në shoqëri anonime, i cili u realizua gjatë viteve 1998-1999;
- plotësimi i kuadrit ligjor dhe vlerësimi i pasurisë;
- përzgjedhja e investitorit strategjik në bazë të legjislacionit në fuqi.

Lidhur me Albrtransport Sh.a. do të koordinohet privatizimi i saj me realizimin e një kontrate koncensionare (BOOT), që do të përdoret për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në Aeroportin e Rinasit dhe për shërbimet aero/joeroportuale. Procesi asistohet nga kompania ndërkombëtare Deloitte & Touche.

Në sektorin e **porteve** përfshihen Portet e Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës ku kryejnë aktivitetin e tyre ndërmarrjet e shërbimeve portuale, Regjistri Detar dhe Ndërmarrja e Kontrollit të Mjeteve Detare. Deri tani procesi i privatizimit është shtrirë në aktivitetet ndihmëse dhe të shërbimit.

Procesi i privatizimit të Portit të Durrësit do të kalojë këto stade:

- transformimi në shoqëri anonime, i cili u realizua gjatë vitit 1999;
- privatizimi i infrastrukturës ndihmëse;
- zbatimi i projektit të ristrukturimit të Portit Durrës sipas masterplanit të miratuar. Ristrukturimi do të përfshijë kthimin e portit në port veglash, ku të gjitha shërbimet do të jenë private dhe autoriteti portual do të luajë rolin e një enti rregullator.

Metodat e privatizimit do të jenë transferimi i të drejtës së përdorimit e zhvillimit.

Për Autoritetin Portual Sh.A. Durrës, me asistencë të kompanisë ndërkombëtare HPC Hamburg, do të fillojë zbatimi i programit të privatizimit të përpunuar në bashkëpunim me projektin e Bankës Botërore, me kontrata koncensionare të terminaleve të trageteve, konteinerëve, drithrave etj..

E njëjta procedurë po zbatohet edhe në portet e tjera.

Privatizimi në sektorin e **hekurudhës** do të realizohet nëpërmjet këtyre fazave:

- transformimi në shoqëri anonime, i cili u realizua në dhjetor të vitit 2000;
- privatizimi i sektorëve ndihmës jofunksionalë do të bëhet gjatë viteve 2001-2002;
- ristrukturimi i D.P.M. dhe kryerja e studimit për privatizimin e hekurudhës, gjatë vitit 2001-2002.

6- PËR SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË TË POPULLATËS

Në këtë sektor funksionojnë rreth 52 ndërmarrje ujësjellësi, të cilat ndodhen në një situatë të vështirë dhe mundësojnë një minimum të nevojave të popullsisë. Aktualisht, mbi 90 për qind e ndërmarrjeve subvencionohen nga shteti.

Privatizimi do të jetë një alternativë për të përmirësuar situatën duke synuar uljen e kostos të shfrytëzimit, rritjen e efikasitetit të punës, mundësi për investime kapitale, përmirësim të nivelit të shërbimit. Shteti përmes Entit Rregullator, gjatë procesit të privatizimit dhe më pas, do të ruajë të drejta të veçanta në përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e burimeve ujore, në mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë të burimeve ujore në aspektin higjeno-sanitar dhe ambiental, në mbikëqyrjen e veprimtarisë të operatorëve privatë në përputhje me ligjet .

Për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, janë hedhur këta hapa dhe:

- është hartuar një masterplan për furnizimin me ujë të pishëm si dhe për grumbullimin, përpunimin dhe largimin e ujrave të ndotura;
- do të plotësohet kuadri ligjor;
- do të ristrukturohen ndërmarrjet e ujësjellësve dhe të kanalizimeve duke realizuar transformimin e tyre në shoqëri tregtare brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2001.

Privatizimi i ndërmarrjeve të ujësjellësve do të bëhet rast pas rasti, për një ndërmarrje të vetme apo për grup ndërmarrjesh me këto metoda:

1. kalimin e të drejtës të përdorimit përmes kontratave të shërbimit, të qirasë dhe të administrimit;
2. kalimin e së drejtës të zhvillimit, përmes kontratave të koncensionit.

Aktualisht, në sektorin e ujësjellësve është privatizuar me kontratë koncensionare Ndërmarrja e Ujësjellësit Elbasan. Gjithashtu, janë në proces privatizimi me kontratë administrimi shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të bashkive të rretheve Sarandë, Durrës, Lezhë, Fier dhe Kavajë. Gjatë vitit 2002 do të realizohet privatizimi me kontratë koncensionare i ujësjellësve të qyteteve Berat dhe Kuçovë.

Privatizimi i shoqërive me kapital të përbashkët

Shoqëritë me kapital të përbashkët (*joint-venture*) në përgjithësi të formës SHPK, përkufizohen si një partneritet midis shtetit dhe personave privatë fizikë ose juridikë, që veprojnë në një ndërmarrje dhe ndajnë rreziqet dhe përfitimet e shoqërisë.

Krijimi i këtyre shoqërive fillimisht u motivua nga ideja e një kërkimi për bashkëpunim me investitorë dhe partnerë të huaj sepse:

- ndërmarrjet shtetërore mund të hyjnë në tregje të reja eksporti;
- partneri i huaj mund t'i ofronte ndërmarrjeve shtetërore teknologjinë e huaj, kapitalin, administrimin dhe *know-how*.

Në fillim të reformave në Shqipëri (fillimi i 1990) situata e ekonomisë ishte kaq e keqe sa që të gjitha shpresat u vunë në ndihmën dhe investimet e huaja.

Në këtë kontekst, pas miratimit të kuadrit ligjor, për bashkëpunimin midis ndërmarrjeve shtetërore dhe sektorit privat, i huaj apo vendas, u hap drita jeshile. Kjo do të thotë se ndërmarrjet filluan të kërkonin partnerë të huaj, të cilët mund të sillnin në Shqipëri lëndë të para, teknologji të re, të gjenin tregje të reja dhe të mbanin ndërmarrjen në punë. Në përputhje me këtë kuadër ligjor, për krijimin e një SHKP mjaftonte një marrëveshje dhe një statut ndërmjet ortakëve. Deri në fund të vitit 1993 ishin krijuar 99 SHKP (ose 71 % e totalit) (*shih tabelën*).

Tabelë: Numri i SHKP të regjistruara në vite.

Viti	Numër	%
91-92	28	20.0
93	71	51.0
94	30	21.6

95	8	6.0
Pa informacion	2	1.4
Totali	134	100 %

Në atë kohë nuk kishte aspak përvojë për të tilla bashkëpunime, kuadri ligjor i vendit nuk ishte i plotësuar, kështu që shumë kontrata u nënshkruan pa i kushtuar kujdes as detyrimeve dhe të drejtave respektive, as interesave të shtetit. Ndërmarrjet shtetërore futën në kapitalin e shoqërisë aktivitet e tyre, plotësisht ose pjesërisht, ndërsa ortakët e huaj duhej të sillnin kapital të freskët, teknologji dhe *know-how*. Si rezultat, në shumë raste teknologjia dhe *know-how* që u soll ishin si të vjetra ashtu edhe të mbivlerësuara, ndërsa për interesat shtetit nuk u kujdesën aspak.

Prandaj ecuria e këtyre SHKP ishte (dhe akoma mbetet) e keqe në shumicën e rasteve (siç ka ndodhur edhe në vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore). Në fakt, më shumë se gjysma e SHKP të krijuara ose nuk punojnë ose janë shkatërruar.

Tabelë: Pjesëmarrja e shtetit në SHKP.

Kuota e kapitalit	Numri	[%]
<10%	6	4.5
10%-20%	10	7.5
20%-30%	16	11.9
30%-40%	27	20.1
40%-50%	23	17.2
50%-80%	3	2.2
80%-100%	2	1.5
Pa informacion	47	35.1
Totali 134	100.0	

Tabelë: SHKP sipas sektorëve.

Sektori	Numri	%
Ndërtim dhe Materiale ndërtimi	28	20.8
Bujqësi	18	13.4
Përpunim ushqimor	13	9.7
Të ndryshme	11	8.2
Tekstile dhe Veshje	9	6.7
Druri dhe letra	8	6.0
Lëkura	6	4.5
Mekanik	6	4.5

Minerar	6	4.5
Shërbimi dhe tregtia	5	3.7
Transporti	5	3.7
Prodhimi artizanal	3	2.2
Industria kimike dhe plastike	2	1.5
Nafta dhe Gazi	2	1.5
Energjitiqë	1	0.7
Metalurgji	1	0.7
Turizëm	1	0.7
Tipografi	1	0.7
Pa informacion	8	6.0
Totali	126	100.0

Aktualisht, po vazhdon privatizimi i kuotave shtetërore për ato shoqëri që kanë mbijetuar.

Privatizimi nëpërmjet kontratave të qirasë dhe enfiteozës

Bazuar në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore MEPP, me të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet, ndër të tjera ka zbatuar metodën “jozhveshëse” nga pronësia për të transferuar të drejtën e përdorimit dhe të zhvillimit të aseteve të ndërmarrjeve, të cilat kishin “humbur” objektin e aktivitetit dhe, njëkohësisht, kontaktin me tregun apo të aseteve të shkëputura të tyre, duke përdorur kontratat e qiradhënies dhe enfiteozëdhënies.

Gjatë viteve 1998-2001, janë realizuar 99 kontrata qiraje dhe enfiteoze për ndërmarrje shtetërore dhe objekte të veçanta të ndërmarrjeve, të shoqërive apo të institucioneve shtetërore.

Nëpërmjet kësaj metode është nxitur interesi i biznesit për të zhvilluar aktivitete krejt të ndryshme nga objekti i mëparshëm i aseteve, në sektorët ekonomikë të industrisë së veshjeve, të këpucëve, mekanike, aktivizimin e minierave të vogla të industrisë së kromit dhe qymyreve, të naftës, të prodhimit të çelikut, të përpunimit të drurit, të material ndërtimit, të plastikës, të përpunimit ushqimor si dhe në infrastrukturën e kulturës dhe sportit.

Në zbatim të kësaj metode, subjektet private parashikojnë një investim prej rreth 84 milionë usd dhe hapjen e rreth 7200 vendeve të reja pune, duke realizuar edhe një të ardhur direkte vjetore nga pagesa e tarifave prej mbi 2,2 milionë usd.

BIBLIOGRAFIA

- “Privatizimi në Shqipëri në vitet 1991-1997” GTZ Gjermani Projekti “Legjislacioni ekonomik, Privatizimi dhe Ristrukturimi”.
- “Strategjia e Privatizimit për sektorët me rëndësi të veçantë të ekonomisë”.
- Statistikat e privatizimit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit 1998-2000.
- Botime të Institutit të Statistikës.
- Materiale dhe informacione të MEPP.